



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 25 Prill 2021

Nr: 298

V E N D I M

**PËR ZËVENDËSIMIN E FLETËVE TË VOTIMIT TË QV NR.2394/1, TË ZAZ NR.47,
QARKU ELBASAN**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n”, dhe paragrafi 2, nenin neni 97, paragrafi 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V Ë R E N

KZAZ nr.47, qarku Elbasan, njofton se në ora 07:00, në ambientet e QV nr.2394/1, komisionerët e kësaj QV-je, znj.Xhesjana Balla, Kryetare dhe z.Gentjan Shehi, Sekretar, kanë konstatuar se mungojnë fletët e votimit të kësaj qendre votimi.

Për sa më sipër KQZ duhet të marrë të gjitha masat për të siguruar të drejtën e votës të zgjedhësve të QV nr.2394/1. Në këto kushte, KQZ duhet të autorizojë KZAZ nr.47 që të marrë masat për të siguruar fletët e votimit të QV nr. 2394/1, nga qendrat e tjera të votimit të ZAZ-së nr.47, dhe për ti dërguar në qendrën e votimit nr. 2394/1 përpara hapjes së votimit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafët 1, shkronja“ç”, dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, paragrafi 2, shkronja “d”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,



VENDOSA:

1. Të autorizojë KZAZ-në Nr.47, qarku Elbasan, që me vendim të marrë 250 fletë votimi nga QV-ja 2394 dhe 250 fletë votimi nga QV-ja 2395 të ZAZ-së Nr. 47 dhe t'i dorëzojë në KQV-në nr. 2394/1. Në total do të të merren 500 fletë votimi për të pajisur QV nr. 2394/1.
2. KZAZ nr.47, të marrë masat që QV nr.2394/1 të pajiset brenda orës 10:00, të datës 25.04.2021, me fletët e votimit nga QV e ZAZ që administron.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

